



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/I6-6 Prot.
Nr. Dok. 202400544/5

Tiranë 10/06/2025

Lënda: Rekomandim për fillimin e procedurave të verifikimit të konstatimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në lidhje me ankesat e të dënuarve me burgim dhe jo vetëm, të ciët duhet të përfitonin në zbatim të Ligjit 33/2024 "Për dhënie amnistie", si dhe mundësia për të aplikuar një procedurë të unifikuar nga organet e prokurorisë në nivel kombëtar.

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Tiranë

Për dijeni: KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe nga administrata e pushtetit gjyqësor, ndjek me vëmëndje dhe çdo nisëm shtetërorë e cila ndikon drejtpërdrejtë në respektimin e tyre.

Kemi ndjekur në mënyrë aktive dhe kemi dhënë kontribut si në momentin e propozimit të projekt ligjit “Për dhënie amnistie”, ashtu dhe aktualisht për zbatimin me korrektësi dhe në kohë të Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” nga organet e ngarkuara për zbatimin e tij.

Jemi njohur gjithashtu dhe me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili sjellë në vëmendje të të gjithë prokurorëve, ndërmarrjen e veprimeve procedural për të siguruar zbatimin e njëjtë dhe në kohë të këtij ligji si dhe të informojnë Prokurorin e Përgjithshëm brenda datës 24.05.2024.

Nga momenti kur hyri në fuqi ligji dhe aktualisht, ne vazhdojmë të trajtojmë ankesa nga persona të cilët po vuajë dënimin në IEVP-të në vend.

Tipologjia e ankesave ka qënë e ndryshme, por ankesat më të shumta kanë patur lidhje me;

- ✓ vonesat në arsyetimin e vendimit përtej çdo afati ligjorë ndonëse vendimi është shpallur shumë më herët se data 31.03.2024, të cilat janë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit penal.
- ✓ mosnxjerrja e urdhërit të ekzekutimit të vendimit penal nga ana e prokurorit ndonëse vendimi penal është shpallur përpara datës 31.03.2024 dhe nuk është ankimuar,
- ✓ vonesa të tejzgjatura të procedurave gjyqësore për rastet e bashkimit të dënimeve dhe keqinterpretime të përllogaritjes së kohës së dënimit nga ana e prokurorit të ekzekutimit,
- ✓ moszbatim i ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” si dhe i Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” të Prokurorit të Përgjithshëm

Si rezultat i mosveprimit të organeve të drejtësisë brenda afateve të parashikuara në legjislacionin penal dhe aktet nënligjore në fuqi, shumë nga personat e ndaluar kanë humbur të drejtën për të përfituara nga falja e dënimit parashikuar në Ligjin nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”.

Në këtë kuadër, përveç ndjekjes dhe shqyrtimit të rasteve individuale të adresuara në institucionin tonë kryesisht nga shtetas që vuajnë dënimin në IEVP të ndryshme në vend, Avokati i Popullit më herët është vënë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj audiovizive¹ me shqetësimin e familjarëve të disa të dënuarve në IEVP Fushë Krujë të

¹ <https://www.syri.net/kronike/683616/syri-tv-ngerci-burokratik-mban-ne-burg-te-amnistuarit-familjaret-apel-nga-burgu-i-fushe-krujes/>
<https://www.youtube.com/watch?v=U3bWA-JiNdY>

cilët dhe pse përfitonin nga zbatimi i ligjit “Për dhënie amnistie”, nuk i kanë lënë ambjentet e vuajtjes së dënimit. Pengesë për këtë veprim është bërë mos zbardhja e vendimi të aryetuar të formës së prerë nga gjykata ose mos lëshimi i urdhërit të ekzekutimit të vendimeve penale nga ana e organit të prokurorisë.

Gjithashtu dhe nga inspektimet e kryera nga grupet e punës së institucionit tonë në disa IEVP, është adresuar kjo ankesë nga disa të dënuar si në IEVP Drenovë dhe në IEVP Vlorë.

Në këto kushte, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “*Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*”, vlerësuam se kjo çështje përmban elemente për t’u marrë në shqyrtim me nismën e institucionit tonë.

Nisur nga fakti se në nenin 8 “Informimi” të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” të Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohej se, të gjitha prokuroritë do të përcillnin brenda datës 25.05.2024 informacionin e detajuar për aplikimin e amnistisë në Prokurorinë e Përgjithshme, iu drejtuam me shkresën nr. K2/I6-2 Prot., datë 10.05.2024 “Kërkesë për informacion” Prokurorisë së Përgjithshme. Në shkresën tonë i kemi kërkuar një informacion të përgjithshëm lidhur me ecurinë e disa procedurave që duhet të ndërmernte organi i prokurorisë në zbatim të amnistisë penale.

Ndonëse kaluan më shumë se dy muaj, si dhe nisur nga përcaktimet në udhëzimin e cituar më lartë duhej që Prokuroria e Përgjithshme gjatë kësaj kohe ta dispononte informacionin e kërkuar nga ana jonë, nuk morëm përgjigje. Në këto kushte, iu drejtuam dhe një herë me shkresën nr. K2/16-3 prot. datë 30.07.2024 “Kërkesë e përsëritur për informacion”.

Në përgjigje të kërkesave tona, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, me shkresën nr.661/2 Prot. datë 16.08.2024 “Kthim përgjigje” na ka përcjellë thjeshtë dhe vetëm një tabelë statistikore pa i dhënë përgjigje pyetjeve tona lidhur me ankesat e shtetasve të cilët pretendonin se për mosveprimeve nga ana e organit të prokurorisë nuk po i aplikoheshin falja nga amnistia, ose rastet e aplikimit në interpretim të ndryshëm nga organi i prokurorisë në rrethe të ndryshme.

Në të njëjtën kohë i ishim drejtuar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila në përgjigje të shkresës tonë ² na ka përcjellë një informacion të detajuar me shkresën nr.8425/2 prot. datë 31.07.2024.

² shkresa nr. K2/17-2 prot. Datë 14.05.2024 “Kërkesë për informacion”

Në vlerësim të informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton një situatë shqetësuese përse i përket aplikimit të Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”. Këto të dhëna vazhdojnë të jenë në këto nivele dhe në fillim të muajit tetor sipas konfirmimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në takimin e zhvilluar në dt.15.10.2024.

Së pari; Sipas këtij informacioni, **kemi 161 raste** ku ka qënë e pamundur të aplikohet falja nga amnistia për të dënuarit të cilët duhej të përfitonin, dhe kjo për shkak të moszbatimit të afateve ligjore nga ana e organeve të drejtësisë. nga të cilat **59 raste** si pasojë e mosveprimeve nga organi i prokurorisë dhe **81 raste** për procedurat e bashkimit të dënimeve.

Në këto raste këtyre të dënuarve i është shkelur një e drejtë legjitime siç është përfitimi i uljes së dënimit apo falja e dënimit të mbetur si rezultat i mos kryerjes së procedurave ligjore nga ana e organeve ligjzbatues, gjithashtu i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Ende sot rezulton që nuk ka gjetur zbatim ligji për këto raste.

Së dyti; Nisur nga ankesat individuale që kemi shqyrtuar lidhur me këtë aspekt, na ka rezultuar nga shqyrtimi ynë administrative që prokurorë në zyra të ndryshme të prokurorive kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të njëjta.

Për shembull, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, prokurore L. Shkurti në urdhërin e ekzekutimit të vendimit penal ndaj shtetasit S. B., dënuar me **vendimin nr.46 shpallur më dt.26.01.2024** i cili i është njoftuar i arsyetuar organit të prokurorisë më dt.20.05.2024 dhe ka marrë formë të prerë në dt.06.06.2024, nuk ka urdhëruar falje nga amnistia pasi vendimi ka marrë formë të prerë pas dt.31.03.2024. (*Vendim i paankimuar*)

Në këtë rast i dënuari nuk ka përfituar nga Ligji nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” pasi gjykata në kundërshtim me parashikimet e K.Pr.P. nuk ka arsyetuar vendimin brenda afateve ligjore dhe organi i prokurorisë nuk e ka konsideruar që ky dënim është dhënë përpara datës 31.03.2024 siç parashikon ligji i amnistisë 2024.

Ndërkohë në të njëjtën situatë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, prokurori A. Bushati në urdhërin e ekzekutimit të vendimit penal ndaj shtetasit J. K., dënuar me **vendimin penal nr.210 dt.12.02.2024** i cili i është njoftuar i arsyetuar organit të prokurorisë dhe ka marrë formë të prerë në dt.10.07.2024, ka urdhëruar falje nga amnistia dhe pse vendimi është njoftuar i arsyetuar pas dt.31.03.2024.

Sa më sipër, mbetet e paqartë si për prokurorët por dhe për personat të cilët duhet të përfitojnë nga amnistia dhe për administratën e IEVP-ve, se për efekt të ligjit për dhënie amnistie kush do të konsiderohet momenti kur vendimi ka marrë formë të prerë, momenti i shpalljes së vendimit duke përllogaritur dhe afatin e ankimit apo momenti kur është

njoftuar vendimi i arsyetuar nga gjykata, pavarësisht se ka tejkaluar çdo afat ligjor dhe afat të arsyeshëm për arsyetimin e vendimit.

Së treti: Dhe sot pas një viti ende në adresën e Avokatit të Popullit vazhdojnë të vijnë ankesa nga shtetasit të cilët nuk kanë përfituar nga amnistia penale për shkak se kemi interpretime të ndryshme të momentit se kur vendimi penal është konsideruar i formës së prerë. Të paktën në dy raste nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rasti i shtetasit **A. G.** dhe shtetasi **P. K.**, dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Fier, rasti i shtetasit **S. B.**, të cilët nuk përfituan nga amnistia sipas Urdhërit të ekzekutimit të vendimit penal, ndonëse vendimi ishte shpallur përpara datës 31.03.2024.

Ndonëse Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” i Prokurorit të Përgjithshëm në nenin 1 “Qëllimi” shprehet qartë që qëllimi i tij ishte të siguronte zbatimin e njëjtë të procedurave për përfitimin nga ligji i amnistisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, nga hetimi ynë administrative nuk rezulton të jetë përmbushur ky qëllim.

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

Nga sa parashtruam më lartë, nga hetimi ynë administrativ lidhur me zbatimin e amnistisë penale, konstatojmë se organet e prokurorisë nuk kanë një interpretim të qartë dhe të njëtrajtshëm të dispozitave të Ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie të amnistisë” në harmonizim dhe me parshikimet e Kodit të Procedurës Penale, Ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” si dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe sigurisë juridike.

Një çështje e cila mund të krijojë pasiguri juridike në rastin e aplikimit të amnistisë penale është përcaktimi i momentit kur vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm, dhe kur konsiderohet që ka marrë formë të prerë: shpallja e vendimit nga gjykata, njoftimi i vendimit ose vendimi i arsyetuar i njoftuar nga gjykata.

Ndonëse Prokurori i Përgjithshëm nxori Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”, konstatohet nga hetimi ynë administrativ se ky udhëzim nuk e ka ezauruar qartazi këtë moment, dhe ka rezultuar se është aplikuar në forma të ndryshme nga zyrat e prokurorive.

Ndonëse të gjitha prokuroritë në zbatim të këtij Udhëzimi, do të përcillnin brenda datës 25.05.2024 informacionin e detajuar për aplikimin e amnistisë në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe sot ne nuk jemi njohur me një qëndrim zyrtar të Prokurorisë së Përgjithshme për problematikat në zbatueshmërinë e ligjit për amnistinë penale.

Avokati i Popullit si dhe të gjithë aktorët e tjerë në fushën e të drejtës, më shumë se kushdo e kemi të qartë situatën që po kalon sistemi i drejtësisë në këtë fazë të implementimit të reformës në drejtësi. Vakancat e shumta, aplikimi i hartës së re gjyqësore, infrastruktura e pamjaftueshme, kanë sjellë pasoja shumë të mëdha dhe të drejtëpërdrejta në dhënien e

drejtësisë, respektimin e standarteve, por gjithashtu dhe në cënimin e disa të drejtave themelore të qytetarëve siç është e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vijimësi sa i përket procesit të rregullt ligjor, në koherencë me zbatimin e reformës në drejtësi është shprehur se: “... në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjyqimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)³.

Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”⁴, dhe në respektim të këtij sanksionimi të rëndësishëm kushtetues dhe një i dënuar duhet të gëzojë të drejtat që ligji i ka njohur gjatë vuajtjes së dënimit.

Ne analizuam në tërësi legjislacioni që ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi penal siç është Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në analizë të rasteve që kemi marrë në shqyrtim rezulton se jo për të gjithë (në kushte të njëjta) amnistia penale e vitit 2024 është zbatuar njësoj.

Në ligjin Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” përcaktohen qartë subjektet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit penal dhe afatet e veprimeve që këto subjekte duhet të kryejnë. Më konkretisht, në nenin 23, pika 1 dhe në nenin 24, përcaktohet se: “Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.

Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve paraprake, sipas nenit 23 të këtij ligji, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe ia dërgon organit vendor të Policisë së Shtetit ku ka vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm ose vendqëndrimin i dënuari.”

Në nenin 2 dhe nenin 3 të Ligjit 33/2024 “Për dhënien e amnistisë”, përcaktohet: “I dënuar” konsiderohet: a) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe **që brenda afatit ligjor nuk është bërë ankim në gjykatat përkatëse të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës 31.3.2024.**

Përjashtohen nga vuajtja e dënimit: a) personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke

³ Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 03.10.2023, pika 21, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 09.11.2023.

⁴ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

*përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, **për dënime të dhëna deri në datën 31.3.2024**, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.”*

Ndërkohë në shumicën e rasteve objekt ankese por dhe të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, i dënuari ose i akuzuari ka ushtruar të drejtën e ankimimit por më pas është tërhequr nga ushtrimi i kësaj të drejte për të mundësuar përfitimin nga aplikimi i Ligjit 33/2024 “Për dhënie amnistie”.

Në këtë rast nëse do ti referohemi Kodit të Procedurës Penale dhe konkretisht nenit 420 pika 4 dhe 462 të K.Pr.Penale⁵, kemi të bëjmë me vendim të cilat për arsye se nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm është vendosur mospranimi i ankimimit, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së parë konsiderohet i formës së prerë dhe në të gjitha rastet janë vendime të cilat janë shpallur përpara datës 31.03.2024, pra dënimi është dhënë përpara datës 31.03.2024.

Sa më sipër, ne duhet të jemi të qartë përsa i përket dallimit midis dy momenteve siç janë, shpallja e vendimit dhe njoftimi i vendimit të arsyetuar.

Nëse i referohemi Kodit të Procedurës Penale, shpallja e vendimit ndodh në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe **përfaqëson deklarin e** rezultatit të gjykimit (fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe sanksionet e vendosura). Ky akt është i rëndësishëm për vënien në ekzekutim të vendimit, në veçanti kur vendimi shpallet me ekzekutim të menjëhershëm ose ***kur vendimi merr formë të prerë***, në mungesë ankimi.

Ndërkohë **njoftimi i vendimit të arsyetuar** nga ana tjetër, është një hap procedural që ndodh pas shpalljes së vendimit⁶, kur palëve u dërgohet vendimi i plotë me arsyetimin juridik mbi të cilin është mbështetur ai. Ky hap është thelbësor sepse shënon ***fillimin e afateve për ushtrimin e të drejtës së ankimit*** – pa arsyetimin, palët nuk mund të njihen në mënyrë të plotë me bazën juridike të vendimit për të vlerësuar nëse do ta ankimojnë apo jo.

Procedurat për aplikimin e ligjit të amnistisë penale duhet të jetë në përputhje me këto rregullime, duke garantuar që **shpallja e vendimit penal** e bën këtë vendim të zbatohet si

⁵ Neni 420 pika 4 K.Pr.P. “Kur gjykata vendos mospranimin e ankimit, vendimi konsiderohet i paankimuar për efekt të vënies në ekzekutim.”

Neni 462 i K.Pr.P. “Vendimet e ekzekutueshme”

1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

2. Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes.

3. Janë vendime të formës së prerë:

a) vendimi i gjykatës së shkallës së parë kur nuk ankimohet nga palët brenda afatit ligjor, kur është i paankimueshëm ose kur nuk pranohet ankimi për shkaqet e parashikuara nga neni 420 i këtij Kodi.

⁶ Neni 382 i K.Pr.P. përcakton se:

1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30 ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

dhe është momenti kur individit i është dhënë (komunikuar) dënimi duke e deklaruar atë fajtor.

Sa më sipër çmojmë se vonesat në arsyetimin e vendimeve penale nga ana e gjykatave përtej afateve ligjore si dhe njoftimi i vendimeve përtej afateve të arsyeshme për vendimet penale të cilat janë shpallur përpara datës 31.03.2024, nuk duhet të cënojnë të drejtën e shtetasve për të përfituar nga ligji 33/2024 “Për dhënie amnistie”.

Siç theksuam dhe më lartë, problematikat që po kalon sistemi i drejtësisë sot, të cilat kanë sjellë si pasoja zvarritje të procedurave gjyqësore, shpesh herë shkeljen e afatve procedural të sanksionuara me ligj nga organet e drejtësisë, nuk mund të cënojnë të drejtat themelore të individit, dhe për më tepër kjo barrë kurrësi nuk duhet ti ngarkohet palëve të përfshira në proceset gjyqësore.

Organet e prokurorisë duhet të kenë një interpretim të qartë dhe të unifikuar të dispozitave të ligjit të amnistisë penale, duke marrë parasysh që ky ligj duhet të zbatohet në përputhje me parimet e drejtësisë dhe sigurisë juridike, si dhe të realizojë qëllimin për të cilin u miratua ky ligj.

Me anë të këtij ligji kërkohej të realizohej lehtësimi i mbingarkesës në sistemin penitenciar dhe promovimi i një politike më të butë ndëshkimi për vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Gjithashtu ligji synonte të ndihmonte në riintegrimin e disa kategorive të dënuarve, veçanërisht atyre me sjellje të mirë, grave, të miturve dhe personave me probleme shëndetësore apo sociale.

Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të individit, për të kontribuar që askush të mos ndihet i diskriminuar, si dhe të garantojë që të gjithë të trajtohen të barabartë përpara ligjit, vlerëson që problematikat lidhur me unifikimin e procedurave për zbatimin e ligjit të amnistisë penale, duke shmangur çdo paqartësi që mund të lindë nga interpretimi i ndryshëm i ligjit, duhen adresuar.

Për sa parashtruam, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në nenin 21/c të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen, si dhe në nenin 73/1 të Ligjit 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, ku parashikohet se: *“Organet shtetërore, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, mund të kërkojnë informacione dhe sqarime në vendet e ekzekutimit të dënimeve për rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e*

të drejtave të të dënuarit, duke rekomanduar marrjen e masave përkatëse dhe, kur e vlerësojnë, mund të kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit”,

REKOMANDOJMË:

1. Verifikimin e konstatimeve të bëra nga institucioni ynë, në kuadër të aplikimit të Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” si dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 570/1 Prot. dt.25.04.2024 “Për zbatimin e Ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie” të Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Të informohet Avokati i Popullit nëse janë marrë masa nga Prokuroria e Përgjithshme për të harmonizuar praktikën lidhur me momentin kur vendimi penal ishte shpallur përpara datës 31.03.2024 dhe njoftimin i vendimit për arsye objektive apo subjektive të organit gjyqësor, është njoftuar përtej afateve të përcaktuara në K.Pr.P. Rastet e vendimeve të gjykatave të shkallës së parë të cilat për arsye të tërheqjes nga ankimimi janë konsideruar sipas nenit 462 K.Pr.P. të formës së prerë nga momenti i shpalljes apo njoftimit.
3. Vlerësojmë se Prokuroria e Përgjithshme duhet të angazhohet në një dialog të vazhdueshëm me organet gjyqësore për të harmonizuar praktikën lidhur me njoftimin e vendimit të përmbledhur brenda një afati të shkurtër (24-48 orë) për të siguruar një procedurë të unifikuar në nivel kombëtar, për vënien në ekzekutim të vendimeve penale sipas afateve procedural penale.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA
D V